



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

MINISTRIA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / RICHJECI PËR KOSOVË
MINISTRI E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Njësia.org: SP-02 Nr. i Prot. 1003-2/24
Org.Jediniça: 06 Broj Prot. 1003-2/24
Nr. i Faqeve: 06 Data: 26.05.25
Nr. Stranica: 06 Datum: 26.05.25
No. Pages: 06

PRISHTINË / A No. 1

DATË/A:	20.05.2025
REFERENC-Ë:	24/1003/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"SharrCem" Sh.p.k. Hani i Elezit, Ndryshim në impiant, për veprimtarinë: Shfrytëzimi i lëndëve djegëse alternative (LDA) nga mbetjet jo të rrezikshme sipas katalogut shtetëror të mbeturinave 191210 "RDF" dhe gomat e përdorura të copëtuara sipas katalogut shtetëror të mbeturinave të pa rrezikshme 160103 në fabrikën e çimentos
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për refuzimin e kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar, të operatorit "SharrCem" Sh.p.k. Hani i Elezit, me nr.prot. 24/1003/MMPHI, për veprimtarinë: Ndryshim në impiant, për veprimtarinë: Shfrytëzimi i lëndëve djegëse alternative (LDA) nga mbetjet jo të rrezikshme sipas katalogut shtetëror të mbeturinave 191210 "RDF" dhe gomat e përdorura të copëtuara sipas katalogut shtetëror të mbeturinave të pa rrezikshme 160103 në fabrikën e çimentos.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/1003/MMPHI
Datë: 20.05.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenin 7, paragrafi 5 të Ligjit Nr.08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit "SharrCem" Sh.p.k. Hani i Elezit, i refuzohet kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar për veprimtarinë: Shfrytëzimi i lëndëve djegëse alternative (LDA) nga mbetjet jo të rrezikshme sipas katalogut shtetëror të mbeturinave 191210 "RDF" dhe gomat e përdorura të copëtuara sipas katalogut shtetëror të mbeturinave të pa rrezikshme 160103 në fabrikën e çimentos, në ngastrat kadastrale sipas Vendimit të Pëlqimit Mjedisor.

A r s y e t i m

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar të operatorit "SharrCem" Sh.p.k. Hani i Elezit, për veprimtarinë: Shfrytëzimi i lëndëve djegëse alternative (LDA) nga mbetjet jo të rrezikshme sipas katalogut shtetëror të mbeturinave 191210 "RDF" dhe gomat e përdorura të copëtuara sipas katalogut shtetëror të mbeturinave të pa rrezikshme 160103 në fabrikën e çimentos, në ngastrat kadastrale sipas Vendimit të Pëlqimit Mjedisor.

Kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar, operatori i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, të lëshuar nga MTI;
- Pëlqimin Mjedisor, të lëshuar nga MMPHI;
- Pëlqim, i lëshuar nga Komuna Hani i Elezit;
- Lejen Ujore për shfrytëzim, të lëshuar nga MMPHI;
- Lejen Ujore për shkarkim, të lëshuar nga MMPHI.

MMPHI, ka kërkuar nga kompania plotësimin e dokumentacionit dhe kushteve të cekura më poshtë:

- Pëlqim nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent (AME) - Rezervuari i mazutit;
- Kompresori i ajrit dhe pajisjet përcjellëse;
- Dokument (Licence ose autorizim) për operim për enët nën shtypje-kompresorët;
- Dokument (Licencë ose autorizim) për operim për enët nën shtypje - rezervuarët e ajrit;

Ajri: Në raport të përfshihen analizat brenda një viti (mars 2023-mars 2024) për:

- Pluhuri;
- SO₂, NO_x, Cd, Hg, Cr, V, Co, Ni, As, Sb, Pb, Ni;
- PCDD/DF;

Për pikat e emisionit :

- Furra rrotulluese dhe mulliri i lëndës;
- Ftohësi i klinkerit;
- Mulliri i çimentos nr.1,2;

- Mulliri i çimentos nr.3 nëse është aktiv.

Ujërat:

- Në raport të përfshihen analizat brenda një viti (mars 2023-mars 2024) për:
- Rrjeti sanitar i ujërave të fabrikës

Mbeturinat:

- Kontratë me kompaninë për grumbullimin e mbeturinave, përfshirë edhe nga procesi teknologjik;
- Kontratë me kompaninë që posedon Leje për grumbullimin/riciklim të vajrave mbeturinë;
- Certifikatë ISO 14001:2015 (International standard - Sistemi i menaxhimit të mjedisit-SMS) Certifikata EMS-2015, dhe linku IAF certifikata;
- Planin e vetmonitorimi- të plotësohet nga operatori;
- Pagesën tarifës për shqyrtimin e kërkesës për Leje Mjedisore të Integruar sipas Udhëzimit Administrativ Nr.13/2015;

Operatori ka sjellë dokumentacionin e kërkuar më lartë, i cili ka të bëjë me lëndët djegëse: Petrol Koksin dhe Mazutin, për të cilën operatori është pajisur me Leje Mjedisore të Integruar.

MMPHI, pas mbajtjes së debatit publik me qytetar me datë: 11.04.2025 për kompaninë "Sharr Cem" Sh.p.k. Hani Elezit, Ndryshim në impiant, për veprimtarinë: shfrytëzimi i lëndëve djegëse alternative (LDA) nga mbetjet jo të rrezikshme, sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave 191210 "RDF" dhe gomat e përdorura të copëtuara sipas katalogut shtetëror të mbeturinave të pa rrezikshme 160103 në fabrikën e çimentos, ka kërkuar informatat shtesë si në vijim:

1.Në faqen 4 të aplikacionit për Leje Mjedisore të Integruar keni deklaruar:

Bashkëprocesimi i LDA, në fabrikën "SharrCem" është një proces i sigurtë i cili nuk ndryshon në thelb procesin e prodhimit dhe as nuk ndikon në kushtet e prodhimit apo shkarkimet në ujë, tokë dhe ajër. Në kompanitë si motra të grupit Titan ka mbi 25 vite që ky proces aplikohet në mënyrë miqësore me mjedisin. Qëllimi është ulja e përdorimit të lëndëve djegëse fosile me rreth 20% përmes përdorimit të disa fraksioneve të mbetjeve si lëndë djegëse alternative, me anë të ndarjes së tyre nga burime të caktuara dhe selektuara të mbetjeve komunale dhe industriale të ashtuquajtura RDF, si mbetjeve të parrezikshme të cilat kryesisht përbëhen nga një përzierje homogjene e plastikës, kartonit, letrës, tekstilit dhe drurit si dhe gomave jashtë përdorimit të copëtuara të definuara sipas katalogut shtetëror të mbetjeve të parrezikshme me numër WC16.01.03. Këto LDA për momentin do të importohen nga jashtë, pasi që në Kosovë

akoma nuk bëhet trajtimi i tyre. Kjo ndoshta do jetë edhe shtytje që të fillohet me përpunimin e këtyre LDA edhe në Kosovë sepse do kishte impakt shumë pozitiv për të reduktuar ndotjet që vijnë nga deponitë grumbulluese të mbetjeve në Kosovë.

2.Në faqen 6 të aplikacionit për Leje Mjedisore të Integruar keni deklaruar:

Kompania "SharrCem" planifikon sigurimin e RDF në fazën fillestare përmes kompanive jashtë Kosovës (pasi që në Kosovë akoma nuk përgatiten lëndë djegëse të tilla) te cilat do të sigurojnë importin e këtij materiali përmes kamionëve me sistem të mbyllur të cilët kanë një dysHEME lëvizëse që bëjnë shkarkimin e materialit drejtëpërdrejt në bunkerin pranues në afërsi të furrës dhe një kamion i tillë me ngarkesën e RDF do të qëndroj në fabrikë për kohën aq sa do të shfrytëzohet ajo ngarkesë.

3.Në faqen 14 të aplikacionit për Leje Mjedisore të Integruar keni deklaruar:

Fillimisht projekti i prodhimit të RDF parashihet të fillohet nga stacioni i transferit të mbeturinave në Gërlicë të Ferizajt i cili është më afër, ku nga sasia ditore e grumbullimit mund të prodhohen prej 17-21 t/ditë RDF, që nënkupton 2 ton RDF në orë.

Në lidhje me pikat 1 dhe 2, duke u bazuar në nënparagrafin 3.3. të pragrafit 3 të nenit 40 të Ligjit Nr.08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina, Importimi i mbeturinave jo të rrezikshme në Republikën e Kosovës lejohet, nëse për objektet dhe pajisjet, në të cilat trajtohen mbeturinat, operatorët e posedojnë lejen përkatëse për trajtimin e mbeturinave jo të rrezikshme, të lëshuar nga Ministria. Përgjatimisht, ndalohej importimi i mbeturinave jo të rrezikshme për qëllime të: trajtimit me djegie të mbeturinave për përfitim të energjisë, në cilin do impiant të pajisura me leje përkatëse mjedisore.

Në lidhje me pikën 3, sipas të dhënave që disponon MMPHI nga Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A. e cila menaxhon me stacionin e transferit të mbeturinave në Gërlicë të Ferizajt, në këtë stacion mbeturinat komunale qëndrojnë përkohësisht deri sa të bëhet transporti dhe deponimi në Deponinë e Veleknicës së Gjilanit dhe në këtë stacion të transferit aktualisht nuk bëhet ndarja e as klasifikimi i mbeturinave.

Andaj duke u bazuar në të cekurat më lartë, MMPHI, ka kërkuar informata shitesë se prej nga do të furnizoheni me lëndë djegëse alternative (LDA) nga mbetjet jo të rrezikshme, sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave 191210 "RDF" dhe gomat e përdorura të copëtuara sipas katalogut shtetëror të mbeturinave të pa rrezikshme 160103 në fabrikën e çimentos?

Operatori nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme, në lidhje me kërkesën e lartcekur nga MMPHI, pasi që ka mos përputhje mes të dhënave në aplikacion dhe gjendjes faktike në terren.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të operatorit në fjalë, duke përfshirë aplikacionin, dokumentacionin shtesë të dërguar që nevojitet për pajisje me Leje Mjedisore të Integruar, gjendjes faktike në terren, debatin embajtur me qytetar, konstaton se dokumentacioni i dërguar nga operatori, nuk është i kompletuar.

Andaj në përputhje me Ligjin Nr.08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, MMPHI merrë **Vendim që operatorit të lartcekur t'i refuzohet kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Inegruar.**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së

Vendimi t'i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës-Hani i Elezit;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së